



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 9/16 prot.,

Datë 14/02/2024

**V E N D I M**  
**Nr. 172/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14/02/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 128/2024, datë 02.02.2024 për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur” me Nr. REF-86763-11-08-2023, me objekt: “Rikonstruksion Zyra Postare qendër Tirana 5, Zyra Postare qendër Durrës” me fond limit 58,439,437.16 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

**Ankimues:** Operatori Ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, me NIPT: K71401004W.  
Adresa: Rruga “Adem Jashari”, Nd. 4, Hrja 10, Nj Bashkiake nr.5, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Posta Shqiptare sh.a.  
Adresa: Rr. “Reshit Çolloku”, Nr. 4 Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”..

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 02.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 128/2024, datë 19.01.2024, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur” me Nr. REF-86763-11-08-2023, me objekt: “Rikonstruktion Zyra Postare qendër Tirana 5, Zyra Postare qendër Durrës” me fond limit 58,439,437.16 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara më sipër.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 2215/21 prot., datë 09.02.2024, protokolluar me tonën nr. 9/13 prot., datë 13.02.2024, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 128/2024, datë 02.02.2024, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e anuluar procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur” me Nr. REF-86763-11-08-2023, me objekt: “Rikonstruktion Zyra Postare qendër Tirana 5, Zyra Postare qendër Durrës” me fond limit 58,439,437.16 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

### II

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

**Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 2215/21 prot., datë 09.02.2024, protokolluar me tonën nr. 9/13 prot., datë 13.02.2024, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 128/2024, datë 02.02.2024, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e anuluar procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-86763-11-08-2023, me objekt: “Rikonstruksion Zyra Postare qendër Tirana 5, Zyra Postare qendër Durrës” me fond limit 58,439,437.16 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 128/2024, datë 02.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-86763-11-08-2023, me objekt: “Rikonstruksion Zyra Postare qendër Tirana 5, Zyra Postare qendër Durrës” me fond limit 58,439,437.16 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.
2. Autoriteti kontraktor në rishpalljen e procedurës së prokurimit të reflektojë në dokumentat e tenderit përcaktimet e Vendimit Nr. 128/2024, datë 02.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të dërgojë këto dokumenta pranë Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

